



Npi – 01/243, datë: 29.10.2020

Kuvendi i Komunës së Shtimes, shqyrtoi kërkesën Nr.01-070/05-20118/20 datë: 08.10.2020, të z.Xhevdet Mehmeti, Rr.”15 Janari” Nr.233 fshati Raçak, i cili në emër të Babës së tij z.Avdyl Mehmet Mehmeti ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, shpronësimin e pronës së paluajtshme me sipërfaqe prej 98 m² në Parcelën 762-0 Zona Kadastrale – Raçak. Prona është marrë nga Komuna me qëllim të zgjerimit të rrugës “15 Janari” dhe rregullimit të trotuarit. Kuvendi i Komunës, duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d) dhe 17 pikat (c) të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008), pasi analizoi kërkesën e palës, si dhe Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, mori këtë:

V E N D I M

PËR FUTJEN NË LISTËN E PRONAVE PËR SHPRONËSIM

I


Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -VIII- të rregullt për vitin 2020, e mbajtur më datën: 29.10.2020, unanimitisht ka vendosur që kërkesa me numër: Nr.01-070/05-20118/20 datë: 08.10.2020, e z.Xhevdet Mehmetit, nga fshati Raçak, të futet në Listën e pronave për Shpronësim, sipas rekomandimit të Drejtorisë për Planifikim Urban Kadastër dhe Gjeodezi.

II

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj